

INISIATIVA "PËR QEVERISJEN E HAPUR
VENDORE PËRMES INOVACIONIT"



VENDIME.AL

ARKIVA KOMBETARE E VENDIMEVE TE KESHILLAVE BASHKIAKE TE SHQIPERISE

VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK ONLINE

FAZA II - FIER, VLORË, BERAT, LUSHNJE

Realizuar nga:



INFOÇIP

Qendra për Çështjet e Informimit Publik

Mbështetur nga:



Të nderuar qytetarë të Fierit, Vlorës, Beratit dhe Lushnjës

Qysh sot, njohja efektive
me vendimet që marrin
në emrin tuaj këshilltarët
bashkiakë është më e
thjeshtë se asnjëherë.
Qendra për Çështjet e
Informimit Publik vndos
në dispozicionin tuaj
platformën online

www.vendime.al

Prej këtu ju mund të lexoni
apo të shkarkoni pa pagesë
vendimet që ju interesojnë.
Nuk ka nevojë të harxhon
kohën tuaj të çmuar për
të ardhur në bashki, por,
direkt nga shtëpia, zyra apo
celulari ju mund të njiheni
me vendimet e Keshillit
Bashkiak, mjafton që të
keni akses në internet dhe
të klikoni www.vendime.al

Mbështetur nga:



Çfarë është VENDIME.AL

www.vendime.al është një
databazë e fuqishme online ku
publikohen vendimet e këshillave
bashkikë.

www.vendime.al ofron mundësi
efektive për cilindro që të njohë
vendimarrjen e të zgjedhurve
vendorë në secilën bashki të
Shqipërisë.

www.vendime.al është emërtimi i
shkurtuar në internet për:

Arkiva Kombëtare e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë në Republikën e Shqipërisë.

Ajo siguron akses të gjërë, efektiv
dhe pa pagesë tek vendimet e
Këshillave Bashkiakë në një portal
të vetëm online.

www.vendime.al është
konceptuar dhe ndërtuar nga
Qendra për Çështjet e Informimit
Publik, INFOCIP. Ajo është në
përditësim dhe në zgjerim të
vazhdueshëm, tashmë edhe
me kontributin direkt të bashkive
përftyuese, të cilat kanë akses
të individualizuar në hedhjen e
vendimeve të tyre.



Kujt i shërben VENDIME.AL

www.vendime.al i shërben në rradhë të parë qytetarëve dhe subjekteve për të njohur dhe zbatuar vendimarrjen e këshillit të tyre bashkiak. Motoja që qëndron në themel të kësaj platforme onlinë është: **“Qytetarët duhet ta dijnë çfarë vendimesh merren në emër të tyre”**. Një qytetar i informuar për normat që qeverisin qytetin e tij është padyshim një qytetar më i mirë.

www.vendime.al i shërben gjithashtu bashkive të Shqipërisë për publikimin e vendimeve të këshillave bashkiakë respektivë. Ky është një detyrim që rrjedh direkt nga ligji organik 8652 **“Për qeverisjen vendore në RSH”**, i ndryshuar (n.35). Mosnjojja e vendimeve të Këshillit Bashkiak nga subjektet dhe qytetarët është në radhë të parë një kosto për vetë administratën e bashkisë, e cila ka për detyrë të implementojë këto vendime.

www.vendime.al i shërben këshilltarëve vendorë, sidomos sekretarëve të Këshillit, për të konsultuar lehtësish online praktikat më të mira vendimarrëse të çdo bashkie në vend, duke adoptuar standartet më të larta në formulimin e vendimeve, konform kërkesave që cakton **ligji 8652**, i ndryshuar.

www.vendime.al i shërben edhe Qeverisë shqiptare, për të vlerësuar më mirë cilësinë e vendimarrjes së autoriteteve vendore si dhe të gjitha agjensive të tjera në nivel qendror që ndërveprojnë institucionalisht me pushtetin vendor.

www.vendime.al i shërben së fundmi të gjithë aktorëve të tjere të interesuar në nxitjen dhe promovimin e vendimarrjes lokale përmes teknologjive të reja dhe inovacionit.

Si funksionon VENDIME.AL

www.vendime.al është e pajisur me dy motorë kërkimi të fuqishëm (kërkim i thjeshtë dhe i avancuar), të vendosur në faqen kryesore të portalit.

Kërkimi i Thjeshtë, kërkon/identifikon VKB-të e synuara përmes “fjalë-kyçeve”. Këto duhet të shkruhen brenda në fushën e kërkimit dhe më pas të pasohen nga shtypja e komandës “**Kërko**”, ose duke klikuar direkt “**Enter**” në tastierë.

Kërkimi i Avancuar realizohet përmes atributeve të vendimit, duke zgjedhur më parë bashkinë përkatësse. Ky motor kërkimi është autentik, pasi është dizenuar në funksion të praktikës shqiptare për caktimin e atributeve të akteve që nxjerrin vendimarrësit vendorë. Ky motor kërkimi ka praktikisht një precision maksimal në identifikimin dhe shfaqjen e vendimit të kërkuar.

Në faqen kryesore, gjendet i pozicionuar dukshëm edhe butoni “**NDIHME**”, i cili ofron të gjitha shpjegimet e nevojshme për një kërkim sa më efektiv në **www.vendime.al**

Të gjitha bashkitë dhe komunat e interesuara për t'u bërë pjesë e programit tonë të dixhitalizimit të vendimeve mund të kontaktojnë me ne duke nisur një kërkësë tek adresat: **duatejem@vendime.al** ose **gendra@infocip.org**

Aktorë të tjera të interesuar për VENDIME.AL

- 1. Qeveria Shqiptare** ka njohur problematikën që lidhet me botueshmërinë e akteve që nxjerr Pushteti Vendor, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike (SNRAP), 2009 – 2013, konstaton se “...vendimet normative të bashkive, degëve të ministritve etj. janë mjaft të vështira për t'u gjendur..” (pika 1.4.1, fq 11). Qeveria ka caktuar objektiva konkretë për t'u realizuar brenda vitit 2013 në nivel lokal, pë të nxitur transparencën në vendimarrjen normative dhe administrative, përdorimin masiv të teknologjisë moderne të informacionit dhe publikimin elektronik zyrtar të vendimeve... (pika 2.3.2, fq. 16).
- 2. Këshilli i Europës**, përmes “Strategjia për Innovacioni dhe Qeverisjen e Mire Lokale” si dhe përmes “Protokolli Shtesë i Këshillit të Europës për Kartën e Vet-Qeverisjes Lokale, Utrecht, 16.XI.2009.

Kush e ka ndihmuar VENDIME.AL

Dixhitalizimi i bazës së vendimeve 2007-2013 për bashkitë Fier, Vlorë, Berat dhe Lushnjë u mundësua falë mbështetjes së Ambasadës së SHBA në Tiranë, në kuadër të Democracy Commission Small Grants Program. Kjo përbën edhe fazën e dytë këtij programi ambicioz të ndërmarrë nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, në kuadër të nismës: Qeverisje e Hapur Vendore përmes INOVACIONIT.

Faza e parë e këtij programi nisi që në vitin 2011 dhe realizoi dixhitalizimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës, si pjesë e mbështetjes së ofruar nga National Endowment for Democracy, NED, (Washington D.C.)

Po ashtu, pjesë e fazës së parë ishte dhe dixhitalizimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak, Korçë (një pjesë e këtij procesi u mbështet nga Open Society Foundation, dhe u finalizua me kontributet e drejprëdrejta të INFOÇIP).

Platforma online www.vendime.al është konceptuar dhe zhvilluar për të qenë e vetë-qëndrueshme, duke lejuar bashkitë pjesëmarrëse në këtë program kombëtar transparency që të ngarkojnë (upload) vetë, në mënyrë autonome VKB-të e tyre.



Procesi i dixhitalizimit u mbështet finanziarish nga Programi i Granteve te Vogla i Komisionit per Demokraci i Ambasadës se Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Opinionet, gjeljet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë portal online janë të autorëve dhe s'përfaqesojnë domosdoshmerisht ato të Departamentit të Shtetit.



BASHKIA FIER

RRETHI FIERI QYTETARET BIZNESI VIZTORET BASHKA

Shpallje Teatrit... More...

Faqja Kryesore Na Kontaktoni Të Reja Publikime Kryetari Kërkoh

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK FIER

Rreth Fierit
Fieri është një qytet i madhe urbane që ndodhet në Shqipëri, jugperëndimore, i rrethuar nga kultura natyrore, arti, kulturë, che praza.

Aktivitetet Kulturore
Fieri organizon mili stërvitë evenimente kulturore me artistike, teatrale, muzikore qitha vjetor për qytetaret e tij, të rinj apo të matur, si dhe për vizitorët.

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK FIER

DEVERISJE E HAPUR VENDORE PËRMES INOVACIONIT

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK FIER

dixhitalizuar nga: **INFOCIP** mbështetur nga: 





BASHKIA BERAT MUNICIPALITY OF BERAT

DEVERISJE E HAPUR VENDORE PËRMES INOVACIONIT

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK BERAT

dixhitalizuar nga: **INFOCIP** mbështetur nga: 







VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK BERAT

KRYETARI FAJL KASUF



BASHKIA VLORE ONLINE

Gjykatë | Turizëm | Kultura / Sport | Bashkia | Kosova i Bashkise | Shërbime | Urbanistika | Galeri

VORA

Mënikorre...
Shqip English

Liberia Ligjore
Vlerësimet
Opinione
Kërkohet
Kontakt

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK VLORE

Kryebashkiaku Sheqetën Gjykatës Ambarasit për zgjedhjet e të dytes, nobiletë përfi parapregjedhje që ekziston në këtë përgjegjje.

Webmaili i Bashkise

DEVERISJE E HAPUR VENDORE PËRMES INOVACIONIT

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK VLORE

dixhitalizuar nga: mbështetur nga:

INFOCIP **UNITED STATES EMBASSY TIRANA, ALBANIA** **U.S. FLAG**

BASHKIA LUSHNJE

Sallëza | Këshilli Bashkiak | Urbanistika | Detyrues | Kultura dhe Sport

Mirësevinë e Bashkise Lushnje

VIVETARI
“Kryetari i Bashkise Lushnje, Dr. Fatmir Tahir, ka bërë një vizitë te Konsullatin Amerikan, Mr. John W. Bissell, në datën 18.06.2013. Konsullati Amerikan, Mr. John W. Bissell, ka bërë një vizitë te Kryetarit, Dr. Fatmir Tahir, në datën 18.06.2013.”

NENI RYETAR
“Kryetari i Bashkise Lushnje, Dr. Fatmir Tahir, ka bërë një vizitë te Konsullatin Amerikan, Mr. John W. Bissell, në datën 18.06.2013. Konsullati Amerikan, Mr. John W. Bissell, ka bërë një vizitë te Kryetarit, Dr. Fatmir Tahir, në datën 18.06.2013.”

FLOMI PER VENDIMET E VENDIMET

VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK LUSHNJE

INFOCIP **UNITED STATES EMBASSY TIRANA, ALBANIA** **U.S. FLAG**

Dixhitalizuar nga: Mundësuar nga:

INFOCIP **UNITED STATES EMBASSY TIRANA, ALBANIA** **U.S. FLAG**

“QEVERISJE VENDORE E HAPUR PËRMES INOVACIONIT”

është nismë e Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP. Llogaridhënia, Transparenca, Ligjshmëria dhe Inovacioni në Pushtetin Vendor janë katër shtyllat bazë mbi të cilat mbështetet kjo Inisiativë. Ajo frymëzohet nga “12 Parimet e qeverisjës së mirë dhe demokratike në nivel vendor” të Këshillit të Eropës, dhe Inisiativa për Qeverisjen e Hapur e Presidentit të SHBA, Barack Obama.

“Qeverisje Vendore e Hapur përmes Inovacionit” ka në fokus të saj proceset vendimarrëse në bashkitë e Shqipërisë. Motoja e këtij programi kombëtar është: “Qytetarët duhet ta dijnë se çfarë vendimesh merren në emër të tyre”.

Inisiativa synon që, përmes teknologjive të reja të informacionit të adresojë njëherë e mirë për zgjidhje problemet serioze të trashëguara në Shqipëri në drejtim të aksesit në legjislacionin vendor. INFOÇIP, ka nisur tashmë dixhitalizimin e vendimeve të këshillave bashkiakë në të gjitha bashkitë kryesore të Shqipërisë, për t'i bërë ato të gjetshme dhe të shfletueshme në internet nga të gjithë të interesuarit, në çdo kohë dhe pa pagesë.

Platforma onlinë www.vendime.al që ka realizuar INFOÇIP është një kontribut ekskluziv i shoqërisë civile dhe është unike në llojin e saj, jo vetëm në rajon por edhe më gjërë. Ajo i siguron një dimension të ri transparence vendimarrjes së pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë.